



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Nr.213 prot.

Puke, 03 . 02.2026

Procesverbal i mbledhjes se kryesise se keshillit , i mbajtur sot me date 03.02 .2026 :

Te njoftuar per mbledhje :

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Alfons Gjegjaj
6. Hazbi Terbuni

Moren pjese:

1. Gjon Gjoka
2. Enver Sulejmani
3. Dritan Asani
4. Besar Kuçi
5. Hazbi Terbuni

Tematika e mbledhjes eshte : Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak” per muajin Janar –Shkurt 2026

Mbledhjen e hapi kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka, i cili prezantoi projekt-rendin e dites te pergatitur paraprakisht ne bashkepunim me kryetarin e Bashkise dhe administraten e bashkise si me poshte vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19.12.2025
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **dhjetor** 2025.
3. Projekt-vendim : Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë , që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike.
4. Projekt-vendim : “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027“
5. Projekt-vendim : “Për përcaktim përdorimi fondi(Grant performance) me burim financimi i huaj”
6. Projekt-vendim : ” Për miratimin e listës së ngastrave të fondit kullosor , që mund të jepen në përdorim për kullotje dhe kositje të përkohshëm”
7. Projekt-vendim : ” Paketa fiskale 2026”
8. Projekt-vendim: ” Për dhënien e titullit ”Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë ”
Z. Rrustem Furriku

9. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë " Z. Pal Kol Lleshi.
10. Kërkesë për dorëheqje e këshilltares Aida Cenaj, këshilltare e subjektit politik PSD.
11. Të tjera.

Ne perfundim te mbledhjes kryesia , pas diskutimit te anetareve vendosi te miratoje te gjitha pikat e projekt-rendit te dites, dhe mori Vendimin nr.1 date 03. 02 .2026, ku u percaktua data dhe ora e zhvillimit te mbledhjes se keshillit, detyrat per sekretarin e keshillit per berjen publike te njoftimit dhe dergimin e materialeve te pergatitura per mbledhjen e keshillit , sipas rendit te dites se miratuar. Po keshtu u percaktua dhe data dhe ora e mbledhjes se komisioneve te perhereshme te keshillit, sipas shenimit ne fund te procesverbalit.

Shënim: Mbledhjet e komisioneve të përherëshme të këshillit zhvillohen më datë 10. 02. 2026 , nga ora 14³⁰ deri ne oren 16⁰⁰ në zyrën e sekretarit të këshillit.

Kryetari I keshillit

Gjon Gjoka





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA**

Nr. 213/1 prot.

Puke, me 03.02.2026

VENDIM

Nr. 1 datë 03.02.2026

“Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr.14 datë 30/06/2020, neni 57, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 03.02.2026;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet më datë 11.02.2026, ora 13³⁰.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit të rendit të ditës, si dhe dosjen me materialet e mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Gjon Gjoka

